



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.368, datë 16.11.2021

**MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË PROKURORIT ARBEN NIKA,
KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KURBIN**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 159, pika 1 dhe 2 germa “a”, 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 32 dhe 52, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në germën “ç”, pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, në Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, të ndryshuar, në pikën 5, të nenit 9, të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë, figurës të prokurorit Arben Nika, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të prokurorit Arben Nika, kandidat për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit prokuror Arben Nika, të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin.
3. Të njoftohet për këtë vendim z. Arben Nika.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**



**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**



**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**



**ANËTAR
MOISI DUDA**



**ANËTAR
VATË STAKA**



**ANËTAR
SANDËR BECI**



**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

